



Republika e Kosovës
Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 307/2025

Datë: 30 prill 2025

Këshilli Prokurorial i Kosovës, në bazë të nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe nenit 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Rregullores Nr.02/2021 për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit, në takimin e mbajtur më datë 30 prill 2025, nxjerrë këtë:

VENDIM

1. Znj. Albana Parduzi, prokurore në Departamentin e Përgjithshëm të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, avancohet në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë nga data 15 maj 2025.
2. Obligohet znj. Albana Parduzi që të koordinohet me Kryeprokurorin e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë për përfundimin e lëndëve të cilat i ka në punë.
3. Znj. Albana Parduzi ka të drejtë në beneficionet që dalin nga ushtrimi i detyrës së prokurorit në Departamentin për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore.
4. Obligohet Sekretariati që këtë Vendim ta publikojë në faqen zyrtare të Këshillit Prokurorial të Kosovës.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Arsyetim

Këshilli Prokurorial i Kosovës në takimin e mbajtur më datë 30 prill 2025 ka shqyrtuar Raportin e Komisionit për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit KPK/KATPSH të datës 16 prill 2025, ku pas shqyrtimit të të njëjtit raport, Këshilli me shumicë të votave dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ardan Hajdaraj

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës



T'i dërgohet:

- Znj. Albana Parduzi;
- U.D. Kryeprokurorit të PTH Mitrovicë;
- Sekretariatit dhe Dosjes së prokurorëve;
- Arkivit të KPK-së.